




REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Shtime



KOMUNA SHTIME
MUNICIPALITY OF SHTIME

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2021-2025



Janar, 2021



Npi – 01/19 datë: 28.01.2021

Bazuar në: Nenin 12.2. pika (d) dhe nenin 17 pika (e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Ligjin Nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës; Ligjin Nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligjin Nr.02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma; Ligjin Nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës; Ligjin Nr.03/L-153 për pyjet e Kosovës; Plani Zhvillimor i Komunës së Shtimes 2010-2020; Plani Rregullues Urban i Komunës së Shtimes; Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Shtimes 2016-2021; Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2021; Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes; Plani për Investime të Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021; Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Shtimes 2016-2020; Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Shtimes 2019-2022; Strategjia e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015-2019; Kuvendi i Komunës, mori parasysh edhe Rekomandimet e Drejtorisë për Shërbime Publike, Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe diskutimin publik me qytetarë, në mbledhjen e mbajtur më 28.01.2021, Aprovoi:

Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2021-2025

Të mbështetur nga:



Building a Greener Economic Environment

Përmbajtja

Fjala e kryetarit të komunës
Falënderim
Komisioni për hartimin e PLVM-së
Indeksi i shkurtesave
Indeksi i tabelave
Indeksi i figurave

1. Hyrje

- 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së
- 1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së
- 1.3. Procesi dhe metodologjia për përgatitjen e PLVM-së

2. Profili i komunës

- 2.1. Pozita gjeografike dhe ndarja administrative
- 2.2. Kushtet klimatike
- 2.3. Pedologjia dhe gjeologjia
- 2.4. Infrastruktura
- 2.5. Zhvillimi ekonomik
- 2.6. Shëndeti publik dhe mirëqenia sociale
- 2.7. Trashëgimia kulturore

3. Presionet në mjedis

- 3.1. Popullsia dhe vendbanimet
- 3.2. Bizneset
- 3.3. Sektori minerar
- 3.4. Transporti
- 3.5. Bujqësia
- 3.6. Turizmi

4. Gjendja e mjedisit

- 4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
- 4.2. Ajri dhe zhurma
- 4.3. Menaxhimi i mbeturinave
- 4.4. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut
- 4.5. Natyra dhe biodiversiteti

5. Problemet kryesore mjedisore

6. Prioritetet mjedisore për periudhën 2021-2025


7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2021-2025

8. Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM-së

9. Referencat dhe burimet e informatave

Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë të komunës së Shtimes, të nderuar lexues!



Kam kënaqësinë që po ndajmë me ju Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2021-2025 për Komunën e Shtimes, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e komunës. Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit, janë identifikuar problemet kryesore mjedisore, janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 vjeçare për mjedisin e Shtimes.

Hartimi dhe miratimi i këtij plani i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën është kërkesë ligjore që del nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës për përmbushjen e përgjegjësisë për fuqizimin e qeverisjes lokale.

Hartimi i planit është si rezultat i punës së komisionit përkatës komunal i cili gjatë punës së tij ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha drejtoritë e komunës, me institucionet tjera relevante të nivelit lokal dhe qendror dhe me specialistë të fushës nga komuniteti dhe organizatat e shoqërisë civile. Rezultat i këtij angazhimi është finalizimi i këtij dokument i cili pritet të ofrojë zgjidhje problemeve mjedisore dhe të përmbush objektivin për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm në komunën tonë.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe me dokumente tjera strategjike dhe zhvillimore të komunës, dhe përmban në vete synimin për një mjedis të pastër në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Shtimes.

Për implementimin e këtij plani komuna ka bërë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por njëkohësisht ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët për implementimin e projekteve konkrete të këtij plani.

Me këtë rast shpreh falënderimin për të gjithë ata që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, e veçanërisht për organizatën CNVP që ka ofruar mbështetje për hartimin e këtij plani dhe gatishmërinë për të përkrahur edhe disa nga aktivitetet e planifikuara në plan.

Ju faleminderit,

Naim Ismajli, Kryetari i Komunës së Shtimes

Falënderim

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, është përgatitur nga komisioni i komunës së Shtimës, në bashkëpunim, konsulencë dhe mbështetje nga Zyra e CNVP(Connecting Natural Values and People) në Kosovë, në kuadër të projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve private dhe të decentralizuara në Kosovë” të mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë (SIDA). Komuna e Shtimes shpreh falënderim për zyrën e CNVP në Kosovë për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në hartimin e këtij plani.

Komisioni për hartimin e PLVM-së

Përbërja e komisionit për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, është përcaktuar me vendimin Nr.02/433 të datës 15.09.2020.

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Medina Brahaj, kryesuese e Kuvendit të Komunës;
2. Rrahman Jakupi, nënkryetar i Komunës;
3. Hamëz Tërshani, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
4. Shqipe Rexhaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi;
5. Fitim Hoxha, drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik;
6. Musa Baftiu, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
7. Kimete Uka, Zyrtare Kryesore Financiare;
8. Sabri Çerkini, KRU “Prishtina”;
9. Osman Muharremi, drejtor i NRPM “Pastërtia” Shtime;
10. Albulena Emini, zyrtare për mjedis;
11. Xhemshir Shabani, përgjegjës i Zyrës për Pylltari;
12. Ekrem Reçica, udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian;
13. Hysen Hyseni, zyrtar nga Zyra e Tatimit në Pronë;
14. Skender Dauti, Shoqata e Peshkatarëve Sportiv “Salmoni”, Shtime;
15. Agron Mehmeti, Shoqata e Pronarëve të Pyjeve Privatë “Gryka e Caralevës”;
16. Ejup Ismajli, Grupi Lokal i Veprimit “Natyra”, Shtime;
17. Resul Gashi, Qendra Rinore Publike, Shtime;
18. Vesa Zeqiri, përfaqësuese e Shoqërisë Civile.

Indeksi i shkurtesave

AMMK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ARRU	Autoriteti Rregullativ për Ujësjetës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DPUKGJ	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
IMMK	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVB	Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Indeksi i tabelave

- Tabela 1:** Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre
- Tabela 2:** Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Shtimes
- Tabela 3:** Tipat e tokave kryesore në komunën e Shtimes
- Tabela 4:** Investimet në infrastrukturë në komunën e Shtimes 2000-2018
- Tabela 5:** Lista e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në komunën e Shtimes
- Tabela 6:** Struktura e popullsisë sipas grup moshave
- Tabela 7:** Struktura sipas përkatësisë etnike
- Tabela 8:** Numri i bizneseve të komunës së Shtimes sipas llojit të veprimtarisë
- Tabela 9:** Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas llojeve
- Tabela 10:** Rrjedhat kryesore ujore në komunën e Shtimes dhe lokalitetet ku shtrihen ato
- Tabela 11:** Burimet e ujit që përdoren për pije në komunën e Shtimes
- Tabela 12:** Qasja në sistemin e ujësjellësit në Komunën e Shtimes
- Tabela 13:** Qasja në sistemin e kanalizimit në Komunën e Shtimes
- Tabela 14:** Burimet e ndotjes së ajrit në Komunën e Shtimes
- Tabela 15:** Sasia mesatare vjetore e konsumit të lëndëve djegëse tek amvisëritë
- Tabela 16:** Sasia mesatare vjetore e konsumit të lëndëve djegës tek shërbimet
- Tabela 17:** Sasia vjetore e konsumit të lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike tek ndërtesat publike
- Tabela 18:** Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sipas sektorëve dhe ndotësve ton/vit
- Tabela 19:** Kategoritë e shfrytëzimit të tokës në komunën e Shtimes
- Tabela 20:** Llojet e mostrave të dheut të analizuara
- Tabela 21:** Shkalla e erozionit në komunën e Shtimes sipas kategorive
- Tabela 22:** Mbulimi i territorit komunës me shërbime të grumbullimit të mbeturinave
- Tabela 23:** Lista e zonave të mbrojtura në Shtime
- Tabela 24:** Problemet kryesore mjedisore
- Tabela 25:** Prioritetet mjedisore për periudhën 2021-2025
- Tabela 26:** Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2021-2025 dhe përgjegjësit për implementim
- Tabela 27:** Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM, indikatorët e suksesit dhe ndikimi i pritshëm

Indeksi i figurave

- Figura 1:** Pozita gjeografike e komunës së Shtimes në Kosovë
- Figura 2:** Harta gjeologjike e komunës së Shtimes
- Figura 3:** Harta vendbanimeve të komunës së Shtimes sipas madhësisë
- Figura 4:** Harta e lumenjve të komunës së Shtimes
- Figura 5:** Deponitë ilegale në komunën e Shtimes sipas madhësisë
- Figura 6:** Deponitë ilegale në komunën e Shtimes sipas llojit të mbeturinave

1. Hyrje

1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Hartimi dhe miratimi i tij është paraparë me Ligjin për Mjedis (2009/03-L-025). Neni 5, pika 3.2 e këtij ligji, ua përshkruan komunave përgjegjësinë, në bashkëpunim me MMPH, për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre. Kurse, pika 3.5 udhëzon: “planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal përkatës”.

Ndërkaq, në mënyrë më specifike, Neni 24 flet për “Planet e Veprimit Lokal në Mjedis dhe Programet Mjedisore” ku pika 1. Specifikon “Komunat miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj”.

Gjatë hartimit të këtij Plani janë marrë për bazë edhe kërkesat e **Strategjisë së Kosovës për Mjedisin 2013-2022**. E zhvilluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, kjo strategji paraqet bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e mjedisit në nivel nacional.

Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet e fushës së mjedisit që prekin interesat në nivelin lokal. Një përshkrim i këtyre ligjeve është prezantuar në tabelën 1.

Tabela 1:Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre¹

Ligji	Qëllimi dhe fushëveprimi
Ligji Nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës	Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësitë institucionale në lidhje me ujërat dhe burimet ujore, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për ujërat.
Ligji Nr.03/L-233 mbi mbrojtjen e natyrës	Me këtë ligj përcaktohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës (e tërë laramanisë biologjike dhe peisazhore) dhe vlerave të saj, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për mbrojtjen e natyrës.
Ligji Nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit. Po ashtu përcakton edhe

¹Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)

	kompetencat e komunave për menaxhimin e cilësisë së ajrit.
Ligji Nr.02/L-102 për mbrojtjen nga zhurma	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare të ndikimeve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës.
Ligji Nr.03/L-153 për pyjet e Kosovës	Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
Ligji Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale	Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Në tabelën 2 janë prezantuar dokumentet planifikuese dhe strategjike të komunës së Shtimes që janë marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të objektivave dhe aktiviteteve të PLVM.

Tabela 2: Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Shtimes

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Plani Zhvillimr Komunal i Komunës së Shtimes 2010-2020	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Shtimes, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
Plani Rregullues Urban i Komunës së Shtimes	Qëllimi i këtij plani është që të organizojë ndërtimet në pjesën urbane të qytetit që është edhe pjesa identifikuese e komunës së Shtimes.
Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Shtimes 2019-2022	Paraqet synimet strategjike zhvillimore socioekonomike me impakt afat-mesëm në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Shtimes. Në mënyrë të veçantë Qëllimi 6, i këtij dokumenti është i fokusuar në përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit.
Statuti i Komunës së Shtimes	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.

Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Shtimes 2016-2021	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta i Shtimes është dokument planifikimi që rregullon Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Shtimes	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Shtimes.
Plani për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes	Në planin e mirëmbajtjes së hapësirave publike të Komunës së Shtimes janë përfshirë aktivitetet për mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike të komunës.
Plani për Investime të Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Shtimes 2016-2021	Plani Investiv ka për qëllim të përcaktojë investimet e orientuara në hapësirat publike për komunën e Shtimes sipas parashikimeve të përcaktuara gjatë hartimit të Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave Publike në Komunën e Shtimes.
Plani i mobilitetit urban për Komunën e Shtimes 2016-2020	Është plan strategjik që ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Qëllimi i planit të mobilitetit urban është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të transportit dhe lëvizjeve të tjera.
Strategjia e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015-2019	Është strategji lokale që ka siobjektiva kryesore: ngritjen e vetëdijes dhe njohjen e rëndësisë së turizmit rural për zhvillim dhe ndikim pozitivë në ekonominë lokale, zhvillimin qëndrueshëm të turizmit rural dhe krijimin e mjedisit të favorshëm për investime dhe stimulimin e bashkëpunimit mes sektorëve publik dhe privat.

1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal për Veprim në Mjedis për komunën e Shtimes është që të identifikoj problemet mjedisore, të përcaktojë prioritetet në sektorin e mjedisit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse.

Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor;
- Të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës së Shtimes;
- Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare;
- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuara.

1.3. Procesi dhe metodologjia e hartimit të PLVM-së

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, Kuvendi Komunal i Shtimes, me datë 15.09.2020, ka miratuar vendim për caktimin e komisionit për hartimin e PLVM, me qëllim që të koordinojë aktivitetet për hartimin dhe miratimin e tij.

Për hartimin e planit, komuna ka marrë mbështetje nga organizata CNVP zyra në Kosovë. Me datën 28.09.2020, është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit në mes të Komunës së Shtimes dhe Organizatës CNVP Kosovë (Lidhim vlerat e natyrës me njerëzit), për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Shtimes.

Metodologjia e hartimit të planit dhe përcaktimit të prioriteteve të tij është orientuar duke u bazuar në:

- **Identifikimin e presioneve kryesore** në mjedisin e komunës së Shtimes, që vijnë nga sektorët e ndryshëm zhvillimorë bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- **Analizën e gjendjes ekzistuese** të mjedisit në Komunën e Shtimes ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale mjedisore bazuar në të dhënat në dispozicion. Në kuadër të analizës së gjendjes është prezantuar gjendja e sektorëve zhvillimorë të komunës dhe gjendja e mjedisit në komunë. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore që ka komuna dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm.

- **Identifikimi i problemeve kryesore mjedisore**të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVM duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.
- Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë **përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën 5 vjeçare** dhe janë grupuar ato sipas tematikave përkatëse mjedisore.
- Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe **plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioriteteve**, që do ti shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVM është propozuar **Plani i monitoimit për zbatimin** e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitoimit sipas prioriteteve.

2. Profili i Komunës

2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ

Komuna e Shtimes ka një sipërfaqe prej 134km² (13.450,8ha), gjegjësisht 1,2 % të territorit të Kosovës. Shtrihet në pjesën Qendrore të Kosovës në koordinatat 42.43, 21.03. Kufizohet me komunat Lypjan në veri, Ferizaj në juglindje dhe Suharekën në perëndim. Gjatësia e pikave më të largëta në territorin e komunës është 19,8 km, në mes fshatrave Karaqicë në perëndim dhe Vojnoc në lindje. Gjerësia maksimale është 13,8 km në mes të komunave Pjetershticë në veri dhe komunës kadastrale Topillë-Devetak në jug.



Figura 1: Pozita gjeografike e komunës së Shtimes në Kosovë

Komuna e Shtimes ka pozitë të mirë gjeografike ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Qendra administrative, qyteti i Shtimes, është 31km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45km larg Prizrenit dhe 13km nga Ferizaj, kurse nga Aeroporti Ndërkombëtarë Adem Jashari është larg vetëm km .

Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është e mirë dhe nuk i ndanë distanca të largëta, por as pengesa natyrore që do ta vështiroshnin komunikimin. Në pozitën e saj gjeografike lugina e Caralevës ka rëndësi komunikatave, jo vetëm për komunën, por edhe në hapësirë më të gjerë. Rruga e asfaltuar Pjetershticë-Komoran e ka shkurtuar lidhjen me pjesët tjera të Kosovës kah perëndimi.

Komuna e Shtimes ka nën administrimin e saj qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, 13 prej të cilave shtrihen në zonën kodrinore - malore dhe 9 në zonën fushore.

Sipas defterit kadastral të vitit 1455, Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës, me qendër në Prishtinë, ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit. Komuna e Shtimes njihet si njësi territoriale - administrative që nga fillimi i shekullit XX, më saktësisht që prej Luftës së Parë Botërore. Komuna e humbet më 1932 statusin e saj, për shkak të politikës shoviniste serbe, të udhëhequr nga Mbretëria e atëhershme jugosllave. Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Shtimja ka funksionuar sërish si Komunë, për ta humbur statusin përsëri në vitin 1959. Më 9 Qershor të vitit 1988 është rithemeluar Komuna e Shtimes dhe sot është qendër komunale administrative e 22 fshatrave.

2.2. Kushtet klimatike dhe relievi

Komuna e Shtimes ka klimë të mesme kontinentale, me dimra mesatarisht të butë dhe me verë mesatarisht të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 10.5 gradë Celsius. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -9. Gradë Celsius, ndërsa më i ngrohi është korriku me 20.4 gradë Celsius. Mesatarja vjetore e reshjeve në territorin e komunës është 633 mm. Sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në muajin maj 81.3 mm, ndërsa ajo më e ulëta në muajin nëntor 41.7 mm.

Mesatarja vjetore relative e lagështisë është 78.7%. Insolacioni vjetor është 2.153 orë. Vranësirat mesatare vjetore janë 52%. Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s në drejtim jug-perëndim dhe 2.8 m/s në drejtimin veri-perëndim.

Pika më e ulët mbidetare në komunën e Shtimes është 545.7 m, ndërsa pika më e lartë mbidetare është 1,290 m. Rreth 54 % e sipërfaqës së komunës i takon lartësisë mbidetare deri në deri 700m, rreth 27% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës i takon lartësisë mbidetare 700-900 m, ndërsa që pjesa tjetër e sipërfaqës (rreth 17%) që përfshinë kryesisht zonat malore i takon lartësisë mbidetare mbi 900 m.

2.3. Pedologjia dhe gjeologjia

Në kuadër të përbërjes pedologjike të tokave të komunës janë pjesëmarrëse tipet më përfaqësuese të tokave: Tokat kafeje, aluviale deluviale, pseudogleje, smonica, livadhore dhe rendzinë. Kurse në areale të caktuara na paraqiten edhe tokat gurore (Tabela 3). Tokat kafeje, smonicat, litoalet dhe rendzinat i takojnë rendit të tokave automorfike, ndërkaq, aluviumet dhe pseudoglejet dhe ato livadhore renditen si toka hidromorfike. Tipat dhe nëntipat e tokave kafeje, i përkasin klasës së tokave kambike dhe eluvialo deluviale. Këto toka për shkak të lagështisë më të madhe dhe ajrosjes optimale, krijojnë kushte të përshtatshme hidro-termike, të cilat ndikojnë në rrjedhën dhe intensitetin e proceseve pedogjenetike, posaçërisht, ato të alterimit kimik dhe biologjik, duke ndryshuar në tërësi strukturën e shkëmbinjve.

Tabela 3: Tipet e tokave kryesore në komunën e Shtimes

Tipet kryesore të tokave	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja %
Toka aluviale	1249.69	9.24
Toka livadhore-argjilore	1090.29	8.06
Toka redezina	176.29	1.3
Toka smonice	872.07	6.45
Toka te kafta	8768.34	64.85
Toka pseudoglej	909.59	6.73
Toka gurore	454.89	3.36
Gjithsej	13422.16	100

Sa i përket bonitetit dominojnë tokat me klasë të VI (62.58%), ndërsa që tipet të tjera të bonitetit janë të përfaqësuara më pak si Klasa e bonitetit II (7.30%), Klasa e bonitetit III (11.03), Klasa e bonitetit IV (11.45), dhe Klasa e bonitetit V (5.68 %).

Bazuar në analizat e hartës gjeologjike të Kosovës, struktura gjeologjike e komunës së Shtimes i takojnë formacioneve të Palezoikut, Triasikut, Jurasikut, Kretanit të sipërm, Neogjenit dhe sedimenteve të Kauternerit. Një përbërje më e detajuar e formacioneve gjeologjike të komunës së Shtimes është prezantuar në figurën 2.




Figura 2: Harta gjeologjike e komunës së Shtimes

2.4. Infrastruktura

Infrastruktura e komunës së Shtimes është zhvilluar në përputhje me planet urbanistike dhe strategjitë e zhvillimit. Si rrjedhojë, në një periudhë rreth 18 vjeçare, janë investuar 44,647,540.00€ në 533 projekte, të cilat janë destinuar për shtrimin e rrugëve (159.73km), ndërtimin e ujësjellësve (104.72km), kanaleve të ujërave të zeza (74.65km) si dhe shtrimin e trotuareve, sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim publik etj. Fshatrat e komunës janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Shtimes, duke krijuar, në këtë mënyrë, një avantazh për zhvillimet e mëtejshme ekonomike, zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin social të komunës. Një tabelë përmbledhëse e investimeve në infrastrukturë nga komuna e Shtimes gjatë periudhës 2000-2018 është prezantuar në tabelë 4.

Tabela 4. Investimet në infrastrukturë në komunën e Shtimes 2000-2018²

Viti i realizimit	Rrugë të asfaltuara (km)	Ujësjetës (km)	Kanalizim atmosferik (km)	Kanalizim fekal (km)	Trotuare (km)	Hapësira të gjelbëruara (m ²)	Ndriçim publik (km)
2000	0	5	0	0	0	0	0
2001	0	5.5	0.55	0.45	0	0	0
2002	0	6	0.1	2.4	0.8	0	0
2003	1.05	29.9	0	0	0	0	0
2004	0	19.6	0.85	1.8	1.2	0	0
2005	3.03	13.7	0.48	0	0	0	0
2006	1.12	15.3	0	0	0.6	0	0
2007	3.76	1.2	1.88	0	1.6	2000	0
2008	8.9	1.4	1.2	0	1.8	0	0
2009	25.7	1.5	3.6	8.3	4	1400	0
2010	1.47	1.8	0.8	4.3	2.8	1200	0
2011	6.5	1.2	0	10.8	2.8	300	6.44
2012	19.96	0.8	0	10.5	0	0	0
2013	51.27	1.2	0.7	13.6	0	500	2.2
2014	32.51	2.5	2.8	6	2.6	0	0.6
2015	3.67	0	0.41	12.37	3.5	8881	2.2
2016	3.35	0.6	0.69	3.51	1.9	830	2.1
2017	1.20	0	0.65	0.62	1.2	1320	1.0
2018	15.16	0	13.32	9.28	7.8	9195	2.87
Gjithsej	175.33	104.72	28.03	83.93	32.6	25626	17.41

2.5. Zhvillimi Ekonomik

Zona Ekonomike në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3). Zona përfshin një sipërfaqe prej 10.7ha. Në Parkun Teknologjik në Shtime janë të vendosura 12 biznese, 7 prej tyre kanë filluar veprimtarinë, kurse 5 biznese janë në fazën e investimeve kapitale. Numri i të punësuarve në Parkun Teknologjik është 105, në vitin 2018 dhe deri në vitin 2020 numri i të punësuarve do të rritet në 160. Bazuar në planet e biznesit në Parkun Teknologjik do të punësohen 217 punëtorë të rregullt dhe ofro 100 sezonalë, ndërsa vlera e planifikuar e investimeve është 9,968,200€.

²Komuna e Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi




Foto 1: Zona Ekonomike në Shtime

2.6. Shëndeti Publik dhe Mirëqenia Sociale

Kujdesi shëndetësor³ në komunën e Shtimes është i organizuar dhe ofrohet përmes sektorit publik shëndetësor dhe atij privat. Komunitat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Kujdesi primar shëndetësor publik ofrohet përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF “ Dr Vezir Bajrami” në Shtime dhe katër Qendrave të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Muzeqinë, Pjetërshicë, Petrovë dhe Godanc. Veprimtari e QKMF-së është ofrimi i shërbimit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës së Shtimes dhe të tjerëve, sipas shtrirjes territoriale dhe gjeografike, t’u ofrojë shërbim shëndetësor gjithpërfshirës, të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për pacientët në sistemin shëndetësor dhe, njëherit, pikë referuese në nivele të tjera të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor.

³Komuna e Shtimes, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Shërbimet sociale profesionale dhe asistenca sociale për qytetarët tanë ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS), në Shtime, ku funksionojnë dy shërbime: Shërbimi Social

Profesional dhe Skema e Ndihmave Sociale. QPS e ka statusin e institucionit juridik dhe publik, ku ofrohen përkujdesje dhe shërbime adekuate sociale profesionale si dhe forma të mbrojtjes sociale, në bashkëpunim me partnerët e tjerë, për çdo kategori të qytetarëve në nevojë sociale e familjare, konform legjislacionit në fuqi, që ndërlidhet me këto shërbime.

Shërbimet rezidenciale institucionale ofrohen përmes Shtëpisë së Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar mendore në Shtime. Ky shërbim ka kaluar në kompetencë dhe menaxhim të DSHMS - së nga 1 janari i vitit 2016, në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, e lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Shtimes, e nënshkruar nga Ministri dhe Kryetari. Komuna Shtimes tani është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve rezidenciale - institucionale nën mbikëqyrjen e MPMS.

Ofrimi i shërbimeve rezidenciale kryhet duke u bazuar në programin e shërbimeve të identifikuar, në përputhshmëri me standardet minimale të caktuara, duke respektuar rregulloret, udhëzimet administrative, ligjet dhe procedurat e përcaktuara nga MPMS.

Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Shtime ka kapacitet prej 12 shtretërve për pacientë dhe 10 punëtorë që kujdesen për shërbimet ndaj tyre. Organizimi i punës në këtë Qendër bëhet në orar 24 orësh.

2.7. Trashëgimia Kulturore

Trashëgimia kulturore e komunës së Shtimes ane përmban një pasuri të madhe vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot.

Zbulime arkeologjike janë gjetur në disa vendbanime të kësaj treve. Ndër më të rëndësishmet janë atotë vendbanimit të vjetër në Petrovë, gërmadhat e kishës dhe lokalitetit arkeologjik në Reçakgjurmët e Gjytetit në Topillë etj. Lokalitete dhe gjurmë arkeologjike ka edhe në Mollopolc, Belincë, Carralevë etj.

Nga objektet tjera të trashëgimisë kulturore duhet vecuar edhe disa xhami të vjetra dhe Tyrbja e Shtimes. Sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, në territorin e Komunës së Shtimes në listën e trashëgimisë kulturore janë të evidetuara 14 objekte (tabela 5).

Tabela 5: Lista e monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në komunën e Shtimes⁴

Emri i objektit	Lokalitet	Kategoria e mbrojtjes
Gërmadhat e themeleve të kishës	Petrovë	Lokalitet arkeologjik
Gjyteti i Topillës (Guri i Markut)	Topillë	Lokalitet arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik te Kisha	Reçak	Lokalitet arkeologjik
Gërmadhat e Kishës së Shortarisë	Reçak	Lokalitet arkeologjik
Xhamia e Shtimes	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Tyrbja e Shtimes	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Shtëpia e përshpëritshme	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Cezmja përkujtimore 1943	Zborc	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Reçak	Trashëgimi arkitekturore
Kroi i Xhem Osmanit	Reçak	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Pjetërshticë	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Gjergjaj	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Zotaj	Trashëgimi arkitekturore
Kulla e familjes Fejzullahu	Zotaj	Trashëgimi arkitekturore



Foto 2: Tyrbja e Shtimes

⁴Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme, MKRS 2019

3. Presionet në mjedis

3.1. Popullsia dhe vendbanimet

Zhvillimi demografik është një fushë me rëndësi të veçantë për planifikim dhe zhvillimin e përgjithshëm të një zone. Komuna Shtimes ka popullsi prej 27,324 banorësh⁵, me 4.158 familje dhe me një dendësi popullsie prej 203.91 banorësh/km² dhe me moshë mesatare 27.62 vjeç. Në bazë të të dhënave nga regjistrimi i popullsisë⁶ së vitit 2011, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, shihet se numri i popullsisë në komunën e Shtimes është 27,324 banorë, ku, prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore (50.69%), ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore (49.31%). 7255 e popullsisë jetojnë në zona urbane, ndërsa 20069 në zona rurale (tabela 6).

Tabela 6. Struktura e popullsisë sipas grup moshave

Grup moshat	Numri i popullsis sipas grup-moshave	Përqindja
0 - 9	5,428	19.87
10 - 19	6,124	22.41
20 - 29	4,443	16.26
30 - 39	3,970	14.53
40 - 49	3,016	11.04
50 - 59	1,988	7.28
60 - 69	1,386	5.07
70 - 79	725	2.65
80+	244	0.89
Gjithsej	27,324	100

Struktura e popullsisë që jetojnë në vise rurale dhe urbane ka këtë pjesëmarrje: Popullsia urbane me 7,255 banorë, ose 26.55% dhe Popullsia rurale me 20,069 banorë, ose 73.45%.

Në komunën e Shtimes janë 4,158 ekonomit familjare me një mesatare prej 6.57 anëtarë për familje. Sa i përketë strukturës etnike rreth 97% të popullsisë janë shqiptarë (tabela 7).

Tabela 7. Struktura sipas përkatësisë etnike

Përkatësia etnike	Numri	Përqindja
Nuk janë në dispozicion	19	0.07
Shqiptare	26,447	96.79
Serbe	49	0.18

⁵ Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 - Agjencia e Statistikave të Kosovës

⁶ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, 2011

Turke	1	0.00
Boshnjake	20	0.07
Rome	23	0.08
Ashkali	750	2.74
Gorane	2	0.01
Të tjerë	13	0.05
Gjithsej	27,324	100

Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti), sipas vitit 2011, është 536 lindje, nga të cilat 290 të gjinisë mashkullore, ndërsa 246 të gjinisë femërore, ose, shprehur në promilë, 19.61‰. Norma mesatare vjetore e vdekjeve (mortaliteti), sipas vitit 2011, është 85 vdekje, nga të cilat 55 të gjinisë mashkullore, ndërsa 30 të gjinisë femërore, ose, shprehur në promilë, 3.11‰. Pra, shtimi natyror për vit, në komunën e Shtimes, është 16.5‰.

Komuna ka 23 vendbanime, duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore – malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. 1 vendbanim (qyteti i Shtimes) i takon vendbanimeve me 5000-10.000 banorë, 5 vendbanime janë në kategorinë prej 2000-2999 banorë, 7 vendbanime kanë 1000-1999 banorë, 3 vendbanime kanë 500-999 banorë, ndërsa që 5 vendbanime kanë më pak se 499 banorë (figura 3).




Figura 3: Harta vendbanimeve të komunës së Shtimes sipas madhësisë

3.2. Bizneset

Në komunën e Shtimes sipas të dhëneve nga viti 2018 aktivitetin e zhvillojnë 1878 biznese të regjistruara⁷. Dominojnë bizneset që fushëveprimtari të tyre kanë tregtinë (685), prodhimin (203), transportin (198) akomodimin dhe shërbime ushqimi (186), ndërtimtari (180) dhe sektorin e bujqësisë (117). Struktura sektoriale e këtyre veprimtative është prezantur në tabelën 8.

Numri më i madh i aktiviteteve të bizneseve është i përqendruar në vendbanimet përgjatë rrugëve magjistrale, por edhe në vendbanimet e tjera, ku kanë infrastrukturë të përshtatshme.

Tabela 8. Numri i bizneseve të komunës së Shtimes sipas llojit të veprimtarisë

Nr.	Lloji i veprimtarisë se bizneseve	Numri i bizneseve
1	Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatari	117
2	Xehetari dhe gurëthyes	21
3	Prodhim	203
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	4
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete të rivitalizimit	7
6	Ndërtimtari	180
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	685
8	Transport dhe ruajtje	198
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	186
10	Informacion dhe komunikim	28
11	Aktivitete financiare dhe siguri	4
12	Aktivitete të patundshmërisë	3
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	37
14	Aktivitete administrati-ve dhe mbështetëse	19
15	Administratë publike dhe mbrojtje	1
16	Arsim	16
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	26
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	37
19	Aktivitete të shërbimeve të tjera	106
Gjithsej		1878

3.3. Sektori minerar

⁷Komuna e Shtimes,, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat, sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë, në këtë mënyrë, një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

Megjithëkëtë sektori i shfrytëzimit të resurseve minerare është një ndër sektorët që ka ndikim në mjedis në këtë komunë, duke përfshirë ndotjen e ajrit, rrezikimin e komunikacionit dhe degradimin e sipërfaqeve të tokës.

Sipas të dhënave në territorin e komunës operojnë rreth 50 operatorë të shfrytëzimit të resurseve minerare disa nga të cilët nuk kanë licenca. Për një dukuri të tillë ka pasur ankesa edhe nga banorët e zonave ku operojnë këtë operatorë por edhe ankesa dhe reagime edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Madje ka pasur raportime ku është vlerësuar se këta gurëthyes ndodhen shumë afër vendbanimeve.

Tre nga shembujt e këtyre gurëthyesve që kanë qenë pjesë e debateve dhe trajtimit nga organizatat e shoqërisë civile janë një gurëthyes në Carralevë dhe dy gurëthyes në Belincë⁸.




Foto2: Gurëthyesi në Carralevë

⁸ Pyje për Asfalt, Kosovo Democratic Institute (KDI) 2020.





Foto3: Dy gurëthyesit në Belincë

3.4. Transporti

Transporti në veçanti dhe komunikacioni në tërësi është parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të një territori. Komuna e Shtimes karakterizohet me transport rrugor i cili përshkohet prej dy rrugëve magjistrale dhe dy rrugëve regjionale si dhe rrugë të tjera lokale. Rrugët magjistrale janë rruga Prishtinë-Prizren (M25) dhe rruga Shtime-Ferizaj (M25.3), kurse rrugët regjionale janë rruga Carralevë-Komoran (R102) dhe rruga Gjurkovc-Koshare (R207). Përgjatë këtyre akseve rrugore zhvillohet transporti ndër-urban dhe kryesisht është i mbuluar nga kompanitë regjionale të transportit publik të Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt, si dhe disa kompani lokale.

Qyteti i Shtimes edhe pse është kryeqendër komunale nuk ka stacion të autobusëve. Rreth 71% e rrugëve (80 km rrugë) që shtrihen në territorin e komunës së Shtimes janë rrugë lokale, dhe janë nën menaxhimin e Komunës së Shtimes. Vetëm gjatë periduhës kohore 2005-2018, me investime vetanake komuna e Shtimes ka asfaltuar 175 km rrugë.

Qyteti i Shtimes nuk e ka të zhvilluar transport urban, arsye e mungesës së transportit urban shpjegohet me faktin që prej qendrës së qytetit, gati i gjithë qyteti mbulohet me një rreze prej 1000m. Transporti publik ka shtrirjetë kënaqshme dhe nga 23 vendbanime sa ka komuna 17 prej tyre kanë qasje në transportin publik.

Rreth 98% e popullatës së Komunës është e vendosur kryesisht në vendbanimet e mëdha, afër rrugëve të karakterit nacional, fushave dhe luginave lumore që kanë qasje në transportin publik. Kurse, vetëm 2% e popullatës e cila është e vendosur në vendbanimet kodrinore malore nuk kanë transport publik të organizuar.

Komuna e Shtimes ka të hartuar dhe të miratuar Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm, që është një plan strategjik që ka për qëllim të përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Një nga objektivat e këtij plani është edhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit.

Në kuadër të objektivave tjera të këtij plani që ndërlidhen me trafikun janë edhe: rritja e sigurisë në trafik në afërsi të shkollave, përmirësimi i sinjalizimit dhe rregullimi i qarkullimit, rregullimi i parkingjeve, rregullimi i shtigjeve për ciklistë dhe përshtatja e infrastrukturës rrugore për persona me aftësi të kufizuara.

3.5. Bujqësia

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi⁹, veçanërisht kultivimin e drithërave të bardha si grurin, misrin, thekrën, tërshërën dhe disa kultura të pemëve frutore: faroret, bërthamoret dhe arroret si dhe pemë të imta: dredhëza, mjedra, kultura perimore në ambiente të mbyllura dhe ambient të hapur: speca, domate, tranguj, lakra etj, si rrjedhojë e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore dhe pjellorisë së saj, por e dhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron.

Sipas regjistrimit të bujqësisë të realizuar në vitin 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komuna e Shtimes ka 2516 ekonomi bujqësore, 6128 hektarë tokë bujqësore dhe 4352 njësi blegtorale.

Sa i përket fondit blegtoral, dominojnë gjedhet me 3863 krerë, delet me 1430 krerë dhe dhitë me 424 krerë. Në territorin e komunës operojnë²¹ ferma për prodhimin e qumështit, 5 ferma për trashjen e viçave, 12 ferma të deleve, dhe 4 ferma të dhive.

Po ashtu janë aktive 5 ferma të pulave për prodhimin e vezëve, me mbi 30,000 pula vojse dhe një fermë për prodhimin e zogjve për konsum me kapacitet prej 3600 zogj, ndërsa që numri total i pulave në territori në komunës konsiderohet të jetë 70.000 pula. Gjatë viteve të fundit njëzhvillim të veçantë ka marrë edhe rritja dhe kultivimi i bletës, ku sipas të dhënave janë aktiv 49 bletarë me gjithsej 2884 shoqëri bletësh.

Sa i përket kultivimit të kulturave bujqësore dominojnë drithërat e nëveçanti gruri dhe misri (tabela 9). Sipërfaqja e përgjithshme e perimeve është 72 ha, nga të cilat mbi 8.5ha janë serra.

Tabela 9: Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas llojeve¹⁰

Llojet e kulturave bujqësore	Sipërfaqja ha
Gruri	2145
Misri	833
Drithëra tjera (elb, thekër, tërshërë)	68
Bishtajore	93
Patate	22
Kultura foragjere dhe rrënjore	401
Perime	72
Toka djerrina	52
Gjithsej toka të punueshme	3686

⁹Komuna e Shtimes, Sektori për Bujqësi, Pyltari dhe Zhvillim Rural

¹⁰Regjistrimi i Bujqësisë, ASK 2015

Sipërfaqe me pemishte në komunën e Shtimes sipas regjistrimit të bujqësisë janë rreth 45 ha, nga të cilat 32 ha mollë, 6 ha kumbull, 3.3 ha lajthi, 1.5 ha dardhë dhe rreth 2.5 ha pemishte tjera (ftua, arrë, qershi etj.)

Rreth 88 ha të sipërfaqes së tokave bujqësore në komunën e Shtimes është e përfshirë në sistemet e ujitjes.

Që nga viti 2014 në Parkun Teknologjik operon Qendra e Agrobiznesit, e cila tregton pemë dhe perime brenda dhe jashtë Kosovës.

3.6. Turizmi

Në komunën e Shtimes janë të shpallura 3 zona turistike, Llanisht- Topillë, Rancë-Carralevë dhe Dugë. Vlera më e madhe në turizëm është pjesa malore, e cila gjendet në perëndim të qytetit, në fshatrat Mollopolc, Devetak, Llanisht, Topillë, Rancë, Carralevë dhe Dugë. Në këto vargmale ka peizazhe natyrore shumë të bukura. Në këto zona gjenden mbi 200 burime të ujit, po ashtu atrakcion i veçant janë Shpella e Imer Devetakut dhe Shpella e Lakuriqëve. Është shpallur edhe zona turistike Mollopolc-Devetak, e cila ka bukur natyrore, në veçanti ujëvara e Mollopolcit, mbi 90 burime të ujit, lumi dhe pyjet e bukura.

Një zonë tjetër rekreative që ndodhet afër qytetit të Shtimes, është parku i pishave, që po ashtu ka edhe statusin e zonës së mbrojtur të natyrës me sipërfaqe rreth 15 ha.



Foto 5: Fshati Topillë

Potenciale tjera për zhvillimin e turizmit në Komunën e Shtimes janë edhe objektete trashëgimisë kulturore, natyrore dhe historike që ndodhen në territorin e komunës ndër të cilat duhet veçuar: Kështjella mesjetare e Topillës, Kalaja e Petrovës, Kulla e Agush Agës, Tyrbja E Shtimes, Vendlindja e Ahmet Shtimes, Xhamia e Vjetër e Shtimes, Xhamia e Rashincës Xhamia e Carralevës, Kulla e Muhamet Begut, Kulla e Sherif Agës në Vojnovc, Kulla e Ramë Sylës së Vojnovcit, Kulla e Sahitit në Carralevë, Shkolla e Parë në Shtime, Shtëpia e Përshpirtshme, Kisha Ortodokse e Mihail Arkangjelit të Shenjtë, Shpella e Pjetërshiticës, Shpella e Imer Devetakut - Devetakë, Gryka e Llanishtit, Kompleksi Përkujtimor “Masakra E Reçakut” – Reçak etj.

Në territorin e Komunës janë 13 objekte akomodimi dhe rekreacioni (motele, pishina, restaurante) që ofrojnë qëndrim dhe akomodim 24 orë dhe që kanë në dispozicion 70 dhoma dhe 80 shtretër. Numri mesatarë i vizitorëve për një muaj llogaritet të jetë 350¹¹.



Foto 6: Mulliri shekullor i familjes Salihi në fshatin Llanishtë

Komuna e Shtimes ka përgaditur dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural 2015-2019, që tani duhet të rishikohet dhe plotësohet.

Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë:

- Ngritjen e vetëdijes dhe njohjen e rëndësisë së turizmit rural për zhvillim dhe ndikim pozitivë në ekonominë lokale;

¹¹Strategjia e Zhvillimit të Turizmit Rural në Komunën e Shtimes 2015-2019

- Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë së jetës së banorëve të zonës o Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe rritja e punësimit;
- Krijimi i mjedisit të favorshëm për investime dhe stimulimin e bashkëpunimit mes sektorëve publik dhe privat(PPP);

Strategjia ka identifikuar edhe sfidat kryesore për zhvillimin e këtij sektori ndër të cilat veçohen:

- Zhvillimi i paplanifikuar në sektorin e turizmit dhe shkalla e lartë e papunësisë;
- Shfrytëzimi joracional i resurseve turistike rurale, kulturore dhe natyrore;
- Mungesa e regjistrimit të plotë të objekteve turistike dhe mungesa e shenjërimit të tyre;
- Infrastruktura jo e mjaftueshme teknike për zhvillimin e turizmit, e sidomos atij malorë;
- Niveli i ulët i vetëdijes për vlerat e objekteve turistike;

4. Gjendja e Mjedisit

4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

Lumi kryesor në territorin e Komunës së Shtimes është lumi Shtime. Ky lum grumbullon edhe ujërat e lumit të Carralevës, Topillës dhe Mollopolcit. Sipërfaqja e pellgut të lumit Shtime është 102 km², me një prurje vjetore prej 32.26 milion m³. Lumi Carraleva buron në malin Carraleva. Ky lum së pari shfaqet pranë "Qafës së Dulës" dhe vazhdon rrjedhën përgjatë luginës së ngushtë të Carralevës. Lugina zgjerohet në zonën nga fshati Belinc deri në Shtime. Ky lumë konsiderohet si një lumë malor, me gjerësi të shtratis të lumit 3-5 m, dhe deri në 7 m përgjatë rrjedhës së poshtme. Thellësia mesatare e këtij lumi është 50 cm dhe në disa pjesë deri në 1 m. Gjatë stinëve të lagësht uji derdhet në shtratin e lumit dhe përmbyt zonat përreth. Gjatë sezonit të verës përmban sasi shumë të vogël uji, rreth 40 l / s.

Një lumë tjetër me rëndësi që përshkon territorin e komunës është lumi Toplica me gjatësi 14.5 km, nga të cilat 12.9 km ndodhet në territorin e komunës. Burimi i lumit ndodhet në një lartësi mbidetare prej 1200 m.




Figura 4: Harta e lumenjëvetë komunës së Shtimes

Ujërat nëntokësorë në territorin e kësaj komune mund të gjenden në aluvione dhe sedimente të Neogjenit. Pjesa më e madhe ndodhet përgjatë lumit. Akuiferet bazohen në zall dhe rërë në sedimentet Neogjene, me qëndrueshmëri prej 5-15 m me $K_f = 3,9 \times 10^{-3}$ cm / sek (K_f - koeficienti i filtrimit) dhe debiti 2 - 10,0 l / sek. Rezervat e konsiderueshme të ujërave nëntokësore ndodhen në këto sedimente. Një sasi e vogël uji gjendet në aluvionet e lumit Carraleva dhe në fshatin Pjetershtice, zona e burimit të lumit Drenica. Sipas vlerësimeve të bëra bazuar në hartën hidro-gjeologjike, aluvionet dhe sedimentet ku ndodhen ujërat nëntokësore mbulojnë një sipërfaqe prej 43 km².

Sipërfaqja e përgjithshme ujore e komunës përbëhet nga 96.6 halumenj, 6.18 ha përrenj 6.18 ha dhe 2.61 ha kanale ujore. Sipërfaqja totale e tokave ujore është 105.39 ha ose 0.78% e territorit të përgjithshëm të komunës¹².

Cilësia e ujit sipërfaqësorë (të lumenjëve) në territorin e komunës së Shtimes, monitorohet në dy pika monitoruese, në Devetak dhe në Vojnovc, të cilat ndodhen në lumin Shtime, që i takon pellgut të Ibrit. Në këto pika monitoruese, monitorimi kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), dhe monitorohen 10 parametra fizikë, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda. Sipas vlerësimit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), sa i përket parametrave fizik dhe kimik, bazuar në të dhënat e monitorimit në njërin nga stacionet monitoruese (Devetak), cilësia e ujit nuk është e ndikuar shumë në faktorët e jashtëm nga aktivitetet njerëzore dhe cilësia e ujit është shumë e mirë, ndërsa në pikën e dytë monitoruse (Vojnovc) e cila ndodhet pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat për rreth dhe të vetë qytetit të Shtimes, cilësia e ujit të këtij lumi është e dobët. Në këtë gjendje ka ndikuar shkarkimi i ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese, urbanizimi dhe bujqësia. Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç'rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike dhe atyre organike. Edhe sa i përket monitorimit të metave të rënda, janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara për kromin, manganin dhe hekurin në pikën monitoruese në Vojnovc. Vlerësohet që tejkalimi i këtyre parametrave është rezultat i shkarkimeve në trupin ujorë të ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese dhe industriale në këtë zonë¹³.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore në territorin e Komunës së Shtimes. Burim i ndotjes së lumenjëve në komunën e Shtimes, janë mbeturinat që hidhen në këta lumenjë dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumënjë pa ndonjë trajtim paraprak. Në

¹² *Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes*

¹³ *Raporti për gjendjen e ujërave 2015, AMMK.*

tabelën 10 janë prezantuar rrjedhat kryesore të ujit në komunën e Shtimes dhe lokalitetet ku ata shtrihen që janë të rrezikuara nga hedhja e mbeturinave.

Në kuadër të kërkesave të qytetarëve përfshihen edhe nevoja për investime në pastrimin, zgjerimin dhe rregullim të atij lumi të Shtimes. Kjo problematikë ndërlidhet edhe mugesën e menaxhimit dhe e implementimit të projekteve¹⁴.

Tabela 10: Rrjedhat kryesore ujore në komunën e Shtimes dhe lokalitetet ku shtrihen ato

Nr	Lumenjtë	Vendbanimet
1	Rrjedha e lumit Pjetërshtica	Pjetërshticë
2	Rrjedha e lumit Carraleva	Carralevë, Belinc and Reçak
3	Rrjedha e lumit Godanc	Godanc i Epërm and Gjurkocv
4	Rrjedha e lumit Topillë	Llanisht, Topillë, Devetak and Petrovë
5	Rrjedha e lumit Mollopoc	Mollopoc and Petrovë
6	Rrjedha e lumit Shtimja	Muzeqinë, Vojnovc, Shtime
7	Rrjedha e lumit Koshare	Gllavicë

Sa i përket përdorimit të burimeve ujore për pije (tabela 11), janë 9 burime të resurseve ujore që furnizojnë banorët e komunës me ujë të pijes. Shumica e këtyre resurseve janë burime ujore nëntokësore. Kapaciteti total i resurseve ujore që përdoren për pijë në territorin e komunës së Shtimes është rreth 80 l/s.¹⁵

Tabela 11: Burimet e ujit që përdoren për pije në komunën e Shtimes¹⁶

Nr.	Burimet ujore për pije	Tipi i burimit	Kapaciteti l/s	Menaxhimi
1	Shtime	5 puse	60	KRU Prishtina
2	Rashincë	2 puse	10	KRU Prishtina
3	Carralevë	1 burim	10	KRU Prishtina
4	Rancë	1 burim	Nuk ka të dhëna	Komuniteti

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë aktet nënligjore që e rregullojnë mbrojtjen e ujërave të pijshëm. Sa i përket përgjegjësisë institucionale Kompanitë Regjionale të Ujësjellësit (KRU) kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Ndërsa Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik (IKSHPK), është institucion përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK ka obligim që të sigurojë që uji i

¹⁴ Komuna Jonë, Raport i monitorimit të Komunës së Shtimes, Organizata Polis, 2017

¹⁵ Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes 2010 - 2020

¹⁶ Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes 2010 - 2020

distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik.

Komuna e Shtimes, ndodhet në zonën e shërbimit të KRU Prishtina. Sipas raporteve të IKSHPK, cilësia e ujit të pijes për zonën e KRU Prishtina, sa i përket parametrave mikrobiologjik ka përputhshmëri me standardet 99.9%, ndërkaq përputhshmëria me parametrat kimik është 96.6%¹⁷. Rezultate pak a shumë të ngjashme për cilësinë e ujit të pijes në zonën e veprimit të KRU Prishtina, raportohen edhe sipas Raportit të performancës së KRU-ve për vitin 2018, ku sa i përket parametrave mikrobiologjik përputhshmëria është 100%, ndërkaq përputhshmëria me parametrat kimik është 98.9%¹⁸.

Edhe përkundër investimeve të shumta në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimeve ka ende ende nevojë për investime në këto dy kategori bazike të shërbimeve publike. Në disa lokalitete problematike është ende furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm. Ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm ndodhë sidomos gjatë stinës së verës.¹⁹

Sipas të dhënave të Kompanisë Ujësjellësi Rajonal Prishtina, në Komunën e Shtimes qasje në sistemin e ujësjellësit kanë 3522 ekonomi familjare ose 85% e numrit total të ekonomive familjare (tabela 12).

Tabela 12: Qasja në sistemin e ujësjellësit në Komunën e Shtimes²⁰

Sistemi i ujësjellësit	Venbanimi	Nr. i ekonomive familjare	Furnizimi me ujë
Sistemi i ujësjellësit në Shtime	Shtime	2010	Furnizimi i rregullt
	Godanc i Ulët	320	Furnizimi i rregullt
	Godanc i Epërm		
	Lagja e Pajtimit		
	Petrovë	128	Furnizimi i rregullt
	Mollopolc	11	Furnizimi i rregullt
Sistemi i ujësjellësit në Rashincë	Raçak	90	Furnizimi i rregullt
	Davidovc	108	Furnizimi i rregullt
	Gllavicë	75	Furnizim jo i rregullt
	Gjurkovc	118	Furnizimi jo i rregullt
	Muzeqinë	222	Furnizimi i rregullt
	Rashincë	145	Furnizimi i rregullt
	Vojnovc	180	Furnizimi i rregullt
Sistemi i ujësjellësit në Carralevë	Carralevë	70	Furnizimi i rregullt
	Belincë	25	Furnizimi i rregullt
	Zborc	0	Nuk ka furnizim
Ujësjellësi në Rancë	Rancë	20	Furnizimi i rregullt Nuk ka faturim
Ujësjellësi në Pjetërshticë	Pjetërshticë	0	Nuk ka furnizim

¹⁷ Cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë 2016, IKSHPK.

¹⁸ Raporti i Performancës së KRU-2018, ARRU.

¹⁹ Komuna Jonë, Raport i monitorimit të Komunës së Shtimes, Organizata Polis, 2017

²⁰ Kompania, Ujësjellësi Rajonal Prishtina

Nuk ka ende sistem të ujësjellësit	Topillë	0	Nuk ka furnizim
	Llanisht,	0	Nuk ka furnizim
	Devetak,	0	Nuk ka furnizim
	Karaqicë	0	Nuk ka furnizim
	Dugë	0	Nuk ka furnizim
		Nr.	%
Gjithsej ekonomi familjarë në komunën e Shtimes		4158	100
Ekonomivë familjare që kanë qasje në sistemin e ujësjellësit		3522	85
Ekonomivë familjare që nuk kanë qasje në sistemin e furnizimit me ujë		636	15

Vetëm gjatë periudhës kohore 2001-2018, në Komunën e Shtimes janë rregulluar 176 km të rrjetit të ujësjellësit. Në të njëjtën periudhë kohore, janë rregulluar edhe 28 km kanalizim atmosferik dhe 86 km kanalizim për ujëra të ndotura urbane²¹. Ndërsa qasje në sistemin e kanalizimit kanë 4004 ekonomi familjare ose 96% e numrit total të ekonomivë familjare (tabela 13).

Tabela 13: Qasja në sistemin e kanalizimit në Komunën e Shtimes²²

Sistemi i kanalizimit	Vendbanimi	Nr. i ekonomivë familjare	
Sistemi i kanalizimit në Shtime	Shtime	2025	
	Godanc i Ulët, Godanci i Epërm Lagja e Pajtimit	350	
	Petrovë	150	
	Mollopolc	85	
	Raçak	125	
Sistemi i kanalizimit në Rashincë	Davidovc	125	
	Gllavicë	108	
	Gjurkovc	152	
	Muzeqinë	248	
	Rashincë	150	
	Vojnovc	198	
Sistemi i kanalizimit në Carralevë	Carralevë	132	
	Belincë	108	
	Zborc	48	
Nuk ka ende sistem të kanalizimit	Pjetërshticë	0	
	Topillë	0	
	Llanisht,	0	
	Devetak,	0	
	Karaqicë	0	
	Dugë	0	
	Rancë	0	
		Nr.	%
Gjithsej ekonomi familjarë në komunën e Shtimes		4158	100

²¹Komuna e Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

²²Kompania, Ujësjellësi Rajonal Prishtina

Ekonomive familjare që kanë qasje në sistemin e kanalizimit	4004	96
Ekonomive familjare që nuk kanë qasje në sistemin e kanalizimit	154	4

4.2. Ajri dhe zhurma

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Në komunën e Shtimes, nuk ka ndonjë stacion nacional apo lokal të monitorimit të cilësisë së ajrit, prandaj nuk ka të dhëna të cilave mundë ti referohemi për të vlerësuar cilësinë e ajrit në këtë komunë. Por nëse marrim për bazë të dhënat nga stacionet tjera dhe ngjashmëritë që ka komuna e Shtimes me lokalitetet tjera ku behët monitorimi i ajrit, vlerwsohet dhe pritët që problemi kryesor të jetë ndotja me grimcat PM10 dhe PM 2.5.

Komuna e Shtimes, nuk ka ndonjë industri të zhvilluar që do të ishte burim i ndotjes së ajrit. Andaj burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë ekonomitë familjare, institucionet publike që përdorin lëndë djegëse për ngrohje, transporti dhe operatorët e shfrytëzimit të gurit. Në tabelën 14 janë prezantuar burimet kryesore të ndotjes në komunën e Shtimes.

Tabela 14: Burimet e ndotjes se ajrit në Komunën e Shtimes

Lloji i burimit të ndotësit	Numri i njësive	Aktiviteti i ndotjes	Ndotësit që shkarkohen në ajër
Objektet e ekonomive familjare/amvisëritë (shtëpi dhe banesa)	4095	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pellet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Objektet publike (administrata, shëndetësore, arsimore, kulturore, sportive dhe sociale)	35	Përdorimi i lëndëve djegëse (dru, pellet, naftë etj) për ngrohje	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Objektet e bizneseve te vogla/shërbimet (furrat e bukës, kafe-restaurante, hotele, dyqane, shërbime tjera)	350	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pellet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
Gurëthyesit	53	Eksplotimi dhe thërmimi i gurit	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5
Automjetet (trafiku)	rreth 5000 automjete	Përdorimi i produkteve të naftës për djege Vjetërsia e automjeteve	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO

Bujqësia	Pajiset bujqësore Aktivitet bujqësore	Përdorimi i naftës Përdorimi i plehrave	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO2 Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO
----------	--	--	--

Në komunës e Shtimes vlerësohet se janë 2903 ekonomi familjare që e përdorin drurin si lëndë djegëse. Konsumi vjetor i drurit vlerësohet të jetë 28.901 m³ dru. Mesatarja vjetore e sasisë së drurit të përdorur nga ekonomitë familjare për ngrohje është 9.33 m³²³.

Ndërsa, sipas një hulumtimi të realizuar në kuadër të projektit për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, i mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (JICA), sasia mesatare vjetore e konsumit të drurit në objektet e shtëpive është 11.3 m³ ndërsa në banesa është 8.7 m³.

Sipas këtij hulumtimi sasia mesatare vjetore e konsumit të thëngjillit në shtëpi është 8.4 ton ndërsa në banesa kolektive është 7 ton, kurse sasia mesatare vjetore e konsumit të peletit është 5.2 ton në shtëpi dhe 2.2 ton në banesa (tabela 15).

Tabela 15: Sasia mesatare vjetore e konsumit të lëndëve djegëse tek amvisëritë²⁴

Lloji i lëndës djegëse	Tipi i ndërtesave	
	Shtëpi	Banesë kolektive
Sasia mesatare vjetore e konsumit të drurit	11.3 m ³	8.7 m ³
Sasia mesatare vjetore e konsumit të thëngjillit (lignjit)	8.4 ton	7.0 ton
Sasia mesatare vjetore e konsumit të peletit	5.2 ton	2.2 ton

Hulumtimi ofron të dhëna edhe sa i përket konsumit të lëndëve djegëse edhe në shërbimet e ndryshme sikurse janë furrat e bukës, dyqanet dhe restaurantet. Sasia mesatare vjetore e konsumit të drurit në furrat e bukës është 268 m³, në dyqane 35 m³ ndërsa në restaurante është 30 m³. Sasia mesatare vjetore e konsumit të thëngjillit në dyqane është 8.8 ton ndërsa në restaurante është 38 ton, ndërkaq sasia mesatare vjetore e konsumit të peletit në furrat e bukës është 2.8 ton, në dyqane 20.8 ton kurse në restaurante është 5.2 ton (tabela 16).

Tabela 16: Sasia mesatare vjetore e konsumit të lëndëve djegës tek shërbimet²⁵

²³Sektori i biomasës drunore në Kosovë, Vështrim i integruar mbi kërkesën dhe ofertën për drurin si lëndë djegëse, FAO 2015.

²⁴ Projekti për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, MMPH/JICA

²⁵ Po aty

Lloji i lëndës djegëse	Tipi i shërbimit		
	Furra buke	Dyqane	Restaurante
Sasia mesatare vjetore e drurit	268 m ³	35 m ³	30 m ³
Sasia mesatare vjetore e thëngjilli (lignjit)	0	8.8 ton	3.8 ton
Sasia mesatare vjetore e peletit	2.8 ton	10.8 ton	5.2 ton

Nëndërtesat publike të komunës së Shtimes në kuadër të pjesëmarrjes së burimeve energjetike që përdoren për ngrohje dominon druri me 2.184m³ dhe 2500l naftë (tabela 17). Gjatë vitit 2018 dhe 2019, nëndërtesat publike të komunës së Shtimes nuk është përdorur thëngjilli për shkak të ndalimit të përdorimit të tij nga Ministria e Mjedisit.

Tabela 17: Sasia vjetore e konsumit të lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike tek ndërtesat publike²⁶

Nr.	Burimet energjetike	Konsumi vjetor sasia	Konsumi vjetor MWh
1	Dru	2,184 m ³	3637
2	Naftë	2500 l	270
3	Energji elektrike	373,291 kWh	373

Një kalkulim i përafërt i emetimeve totale vjetore të ndotësve të ajrit sipas sektorëve është prezantuar në tabelën 18.

Nga tabela shihet se burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë emetimet nga djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet dhe institucionet) dhe trafiku.

Tabela 18: Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sipas sektorëve dhe ndotësve ton/vit

	Djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet, ndërtesat publike)	Trafiku	Bujqësia	Gurëthyesit	Gjithsej
Grimcat e pluhurit PM10	322	61	23	23	429
Grimcat e pluhurit PM2.5	314	28	3	5	350
Oksidet e Azotit (NOX)	31	220	80	0	331
Dyoksidi i Sulfurit (SO2)	66	0,1	0	0	66
Monoksidi i Karbonit (CO)	1869	105	6	0	1980

Megjithëkëtë për të pasur një pasqyrë më të detajuar për burimet kryesore të ndotjes dhe ndikimin e tyre, komuna duhet të bëjë një inventar më të detajuar të ndotësve në ajër.

²⁶Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, Komuna e Shtimes

Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi mundë të propozohen edhe masa konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit, sikurse janë aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore në zonën urbane të qytetit, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje, ndërtimi i objekteve industriale larg zonave të banuara urbane si dhe respektimi i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Në kuadër të masave tjera për mbrojtjen e ajrit nga ndotja mundë të përfshihen edhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimi dhe mirëmbajtja e rregulltë rrugëve dhe mbështetja e ekonomive familjarë nëzbatimin e efikasitë termikë në ndërtesa dhe ndërrimin e sistemit të ngrohjes. Në zonën urbane të qytetit, komuna do të duhet të gjej një zgjidhje për ndërtimin e një sistemi të ngrohjes me theks të veçantë për objektet publike.

Trafiku rrugor dhe aktivitetet ekonomike konsiderohen burimet kryesore të **zhurmës** në Komunën e Shtimes edhe pse aktualisht nuk ka ndonjë matje të organizuar të nivelit të zhurmës në komunë. Në mënyrë të veçantë këto burime të zhurmës intensifikohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme sikurse janë aktivitetet e ndërtimit, transporti i mallrave, gurëthyesit, përdorimi i pajisjeve industriale e tjera.

Komuna e Shtimes duhet të ketë për bazë që zhurma është një nga ndotësit e mjedisit dhe matja e nivelit të saj është e nevojshme për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të popullatës ndaj këtij ndotësi. Kjo është edhe kërkesë ligjore që del nga Ligji për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Sipas këtyre kërkesave komuna obligohet të hartoj të Planin e Veprimt dhe Hartën e zhurmës, përmes së cilave do të identifikohen lokacionet që i ekspozohen zhurmës, prezantimi i tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

4.3. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut

Toka është komponent e rëndësishme e mjedisit në të cilën rritet dhe zhvillohet bota bimore dhe shtazore, dhe ku zhvillohet prodhimtaria bujqësore. Shfrytëzimi i tokës bartë me vete edhe mundësin e degradimit dhe ndotjes së saj në mënyrë direkte apo indirekte. Sfidë është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave. Ndikimet e vazhdueshme nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike.

Deri te ndotja e tokës vije kryesisht përmes shkarkimit të ujërave të ndotura, përdorimit të plehrave minerale dhe pesticideve, nga deponitë ilegale të mbeturinave, apo edhe formave tjera të shkarkimit të materieve të dëmshme në tokë.

Në komunën e Shtimes rreth 32% e tokës shfrytëzohet si tokë bujqësore, rreth 46% është pyjë, diku 07% është zonë ndërtimore ndërsa rreth 0.9% është rrugë (tabela 19).

Tabela 19:Kategoritë e shfrytëzimit të tokës në komunën e Shtimes

Kategoria e shfrytëzimit të tokës	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja %
Pyje	6197.3	46.2
Toka bujqësore	4378.8	32.4
Livadhe	367.7	2.7
Kullosa	871.3	6.5
Zona ndërtimore/vendbanime	93.7	0.7
Rrugë	118.1	0.9
Toka djerrina	326.3	2.4
Toka ujore	105.4	0.8
Gjithsej	13420.1	100

Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe industritë kimike, përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale, ndotja e tokës me materie radioaktive, ndotja e tokës me metale toksike si dhe ndotja e tokës me mikro organizma patogjen. Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm. Megjithëkëtë ky problem është adresuar përmes projekteve specifike. Një nga këto projekte ka qenë projekti i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për studimin e tokës bujqësore në Kosovë (ALPS-Agriculture Land Pollution Survey). Qëllimi kryesorë i projektit ka qenë të bëjë vlerësimin e ndotjes së tokës bujqësore.

Në kuadër të projektit janë analizuar mostrat toke për 17 metale të rënda, mostra toke për treguesit e pjellorisë, mostra toke për përmbajtjen e ndotësve organik dhe mostra bime për metale të rënda. Vlerësimi i ndotjes së tokës ka qenë i orientuar në zonat potenciale të ndotjes si: zonat industrial, uji i ndotur dhe mbetjet, përmbytjet, aktivitetet bujqësore etj. Në tabelën 20 janë paraqitur llojet e mostrave të analizuar të dheut në komunën e Shtimes.

Tabela 20: Llojet e mostrave të dheut të analizuar²⁷

Tokë bujqësore /ha	Mostra/ha	Mostra të analizuar për metale të rënda	Mostra të analizuar për parametra të pjellorisë së tokës
2,629.00	100	53	53

Në kuadër të rezultateve kyçe të projektit thuhet se: përqendrimet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cr, Ni, Cd, Pb, Hg, Zn, Cu, si dhe Ni) janë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se nuk është identifikuar ndotja e të lashtave (perime, drithëra dhe fruta), nga metalet e rënda (në veçanti Cr, Ni, Pb, Zn,), prej mostrave të tokës për qëllime bujqësore.

Në komunën e Shtimes ekzistojnë rreth 30 deponi ilegale të mbeturinave komunale që janë si burime të ndotjes së tokave.

Ekspluatimi i resurseve minerare është një dukuri tjetër, e dëmtimit të tokës në komunën e Shtimes. Në bazë të të dhënave të Komisionit të Pavaruar të Minierave dhe Mineraleve, në territorin e komunës së Shtimes operojnë 53 operatorë që si subjekt të veprimtarisë kanë ekspluatimin e gurit dhe të rërës. Nga këta operatorë 25 operatorë që kanë licenca për veprimtarinë e tyre dhe 9 operatorë që nuk kanë licenca për veprimtarinë e tyre²⁸.

Faktorët tjerë që dëmtojnë cilësinë e tokave në Shtime janë edhe: ndërtimet e paplanifikuara, erozioni, dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

²⁷Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, MMPH/GIZ 2015

²⁸ Burimi i informacionit: <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

Nuk ka informacione të plota për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga erozioni. Një vlerësim i përafërt është bërë në kuadër të procesit të hartimit të Planit Zhvillimorë të Komunës (tabela 21). Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020. Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës.

Pra, për parandalimin e erozionit kërkohet një serë masash teknike, programore dhe ligjore sikurse janë: Kufizimi i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe zhvillimi i kontrolleve adekuate për secilën zone, përcaktimi ligjor i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe informimi i rregullt dhe dhënia e udhëzimeve për të gjitha entitetet e prekura.

Tabela21: Shkalla e erozionit në komunën e Shtimes sipas kategorive²⁹

Kategoritë e erozionit në Komunën e Shtimes	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja %
Erozion shumë i dobët	2445	18.1
Erozion i dobët	8038	59.45
Erozion i mesëm	1938	14.72
Erozion i fortë	11.37	0.08
Erozion shumë i fortë	1036	7.6

Në komunën e Shtimes janë me rendësi dy zona sa i përket **përmbytjeve**:

- **E para** është zona malore ku përrenjtë e vegjël gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë të rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe;
- **E dyta** në zonën e rrafshët ku për shkak të mungesës së pjerrësisë së terrenit ujit të shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

Në territorin e Shtimes nuk janë të theksuara dëmet nga **përmbytjet**. Kjo arsyetohet me faktin se nuk ka lumenj të mëdhenj, përkatësisht sipërfaqja e pellgjeve është e vogël. Megjithëkëtë në qytetin e Shtimes ka pasur raste kur lumi ka dalë nga kanali i tij dhe ka sjell dëme objekteve përreth. Kjo ka ndodhë për shkak të ngushtimit të kanalit dhe mbeturinave të ndryshme. Me zgjerimit e kanalit të lumit është rritur profili i tij dhe kapacitet më të madh. Edhe lumi i Carralevës ka kanal të cekët, prandaj, herë pas here del nga shtrati dhe përmbyt rrafshin aluvial të tij.

²⁹Plani Zhvillimor i Komunes së Shtimes

4.4. Menaxhimi i mbeturinave

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është ende në fazën e zhvillimit dhe avancimit. Në komunën e Shtimes gjatë viteve të fundit është shënuar progres në menaxhimin e mbeturinave. Problemet kryesore për sektorin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta janë identifikuar dhe janë adresuar për zgjidhje përmes **Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Shtimes 2016-2021**, andaj Plani Lokal i Veprimit në Mjedis duhet ti marrë parasysh këto planifikime të komunës për këtë sektor.

Komuna po ashtu ka hartuar edhe **Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave** në territorin e saj, që ka qëllimi të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave nën përgjegjësi të Komunës në mënyrë të integruar. Me këtë rregullore përcaktohet orari, sistemi dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyra e transportimit³⁰.

Komuna përmes vendimit Nr.01-060/01-663, datë:01.03.2018, ka adresuar edhe problemin e **mbeturinave inerte**. Përmes këtij vendimi është caktuar lokacioni për deponinë e mbeturinave inerte për banorët e Komunës së Shtimes, në Zonën Kadastrale – Belinc e evidentuar si Pasuri Shoqërore e Ekonomisë Pyjore, me sipërfaqe të përgjithshme prej: 17055 m² (pjesa e Ngastrës Kadastrale Nr.6-69, me sipërfaqe prej 6129 m², dhe pjesa e Ngastrës Kadastrale Nr.6-70, me sipërfaqe 10926 m²). Shfrytëzimi i Lokacionit për hudhjen e mbeturinave inerte sipas dispozitivit të këtij vendimi do të bëhet për 5 (pesë) vite³¹.

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Shtimes nuk shtrihen në të gjitha vendbanimet e komunës, dhe nuk përfshinë të gjitha ekonomitë familjare. Nga numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të komunës së Shtimes (4158 ekonomi familjare), rreth 2099 ekonomi familjare ose 50.5% e tyre janë të përfshirë me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave (tabela 22).

³⁰Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Shtimes, 2018

³¹ Vendimit i Kuvendit Komunal të Shtimes, Nr.01-060/01-663, i datës 01.03.2018, për caktimin e lokacionit për mbeturina inerte.

Tabela 22: Mbulimi i territorit komunës me shërbime të grumbullimit të mbeturinave³²

Shërbimet për grumbullimin e mbeturinave në komunën e Shtimes	Nr.	%
Numri i përgjithshëm i banorëve (regjistrimi 2011)	27,324	100
Numri i banorëve të shërbyer (2019)	13,793	50.5
Ekonomi familjare në komunë (2011)	4,158	100
Ekonomi familjare të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave (2019)	2,099	50.5
Institucione publike në komunë	32	100
Institucione publike të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave (2019)	28	87.5
Numri i bizneseve aktive në komunë	350	100
Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave (2019)	298	85.1%

Sa i përket aseteve komunale për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, Komuna e Shtimes ka 2163 kontejnerë të madhësive të ndryshme, 3 kamionë dhe 3 traktorë.

Në ditë grumbullohen dhe zbrazen 30 tonë mbeturina. Sasia e deponimit të mbeturinave për kokë banori në vit është 105.7kg. Shkalla e arkëtimit për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave gjatë vitit 2019 është përmirësuar dukshëm dhe ka arritur në rreth 98%.

Sasia totale e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2019, në Komunën e Shtimes ishte 3,363.51 ton. Brenda një viti gjenerohen 243.85 kg për kokë banori, ose 0.67 kg mbeturina në ditë për kokë banori.

Mbeturinat e grumbulluara nga KRM "Pastërtia", dërgohen në stacionin e transferit në Ferizaj, e prej aty mbeturinat dërgohen për deponim në Deponin Sanitare në Velekincë të Gjilanit.

Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin ende një ndër problemet kryesore në sektorin e mbeturinave në komunë (figura 5 dhe 6). Në vitin 2019 janë evidentuar 31 deponi ilegale të mbeturinave. Sipas madhësisë 7 janë deponi të vogla (1-5 thasë 200 l), 12 janë deponi të mesme (6-12 thasë 200 l) dhe 12 janë deponi të mëdha (mbi 12 thasë 200 l).

³²Raporti për gjendjen e mbeturinave komunale 2019, AMMK

Deponite e mbeturinave sipas madhësis




Figura 5: Deponitë ilegale në komunën e Shtimes sipas madhësisë

Deponite ilegale sipas llojit të mbeturinave




Figura 6: Deponitë ilegale në komunën e Shtimes sipas llojit të mbeturinave

Sa i përket riciklimit Komuna e Shtimes ende nuk ka arritur të realizojë ndonjë program të organizuar në tërë territorin e Komunës. Nuk ka ende as programe për ndarjen e mbeturinave në burim, sikurse që nuk ka as iniciativa për kompostimin e mbeturinave organike.

Problematikë tjetër e ngritur nga qytetarët është edhe pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në qytezën e Shtimes. Përveç se nuk ka një mirëmbajtje të mirë edhe për kundër

kontraktimit të kompanisë publike “Pastërtia”, qytetarët ankohen se disa pjesë të qytezës, lagje dhe rrugë kryesore nuk pastrohen fare³³.

4.5. Natyra dhe biodiversiteti

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës³⁴. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës. Ky institucion në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, kanë evidentuar edhe disa zona të rëndësishme të natyrës në territorin e komunës. Në kuadër të listës së zonave të mbrojtura të natyrës në Komunën e Shtimes, padyshim se Shpella e Pjetërshticës, Shpella e Devetakut dhe Kompleksi i pishave të Shtimes, paraqesin zonat me të rëndësishme (tabela 23).

Tabela 23: Lista e zonave të mbrojtura në Shtime³⁵

Emri i Objektit	Vendi	Sip (ha)	Viti i mbrojtjes	Kategoria	Përshkrimi i vlerave	Gjendja	Shenjëzimi
